<p>përkohshëm vendos DSHAM, brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.</p> <p>2. Kundër vendimit nga paragrafi 1 të këtij neni brenda 8 ditëve mund të parashtrohet ankesa për të cilën vendos komisioni, brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.</p> <p>3. Kundër vendimit për refuzimin e lejeqëndrimit të përkohshëm për punë për shkak të plotësimit të kuotës vjetore për punësim, apo në qoftë se akoma nuk është vendosur kuota vjetore për vazhdimin e lejeve të vlefshme, punësimin e ri apo punësimin sezonal, i huaji nuk ka të drejtë ankese por mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 45 Rregullimi i qëndrimit të përkohshëm të fëmijëve të lindur në Republikën e Kosovës</p> <p>1. Prindi ose kujdestari i një fëmije të lindur në Republikën e Kosovës është i obliguar të parashtrojë kërkesë për lejeqëndrim të përkohshëm për fëmijën, jo më vonë se 3 muaj nga data e lindjes.</p>	<p>temporary residence permit, DCAM shall decide upon within 30 days from the date of receipt of the application.</p> <p>2. Against the decision from paragraph 1 of this Article within 8 days may be appealed for which the commission shall decide within 30 days from the receipt of the appeal. The appeal does not suspend the execution of the decision.</p> <p>3. Against the decision to refuse a temporary residence permit for work due to the completion of the annual quota for employment, or if the annual quotas for the continuation of valid permits, new employment or seasonal employment, still has not been set out, the foreigner has no right to appeal, however may initiate an administrative dispute at a Basic Court.</p> <p style="text-align: center;">Article 45 Arrangement of a temporary residence of the children born in the Republic of Kosovo</p> <p>1. The parent or guardian of a child born in the Republic of Kosovo is obliged to apply for a temporary residence permit for the child, not later than 3 months from the date of birth.</p>	<p>privremenog boravka, DDAM mora da odluči u roku od 30 dana od dana prijema zahteva.</p> <p>2. Protiv odluke iz stava 1 ovog člana, u roku od 8 dana može se podneti žalba Komisiji koja odlučuje u roku od 30 dana od dana prijema pritužbe. Žalba ne odlaže izvršenje rešenja.</p> <p>3. Protiv odluke o odbijanju privremene boravišne dozvole za rad zbog ispunjavanje godišnje kvote za zapošljavanje ili nastavak Godišnje kvote za dobijanje dozvola važi, novo zapošljavanje ili sezonsko zapošljavanje, još nije određeno, stranac nema pravo na žalbu, međutim, može da pokrene upravni spor u Centralnom Sudu.</p> <p style="text-align: center;">Član 45 Regulisanje privremenog boravka za decu koji su rođeni u Republici Kosovo</p> <p>1. Roditelj ili staratelj deteta rođenog u Republici Kosovo je obavezan da podnese zahtev za odobrenje privremenog boravka za dete, najkasnije u roku od 3 meseca od dana rođenja</p>
--	--	---



<p>2. Qëndrimi i përkohshëm sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të jepet për kohën në të cilën është lejuar qëndrimi i përkohshëm për prindin ose kujdestarin e fëmijës, ose deri në një vit, nëse njëri prej prindërve ose kujdestari kanë lejeqëndrim të përhershëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 46 Perioda e vlefshmërisë së qëndrimit të përkohshëm</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm lëshohet për një periudhë deri në një vit përveç rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë ligj.</p> <p>2. Periudha e vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit duhet të jetë të paktën 3 muaj më gjatë se periudha për të cilën është lëshuar lejeqëndrimi i përkohshëm.</p> <p>3. Lejeqëndrimi për personat që gëzojnë statusin e refugjatit do të lëshohet për një periudhë vlefshmërie prej së paku 3 vjet dhe e ripërteritshme, përveç nëse arsyet bindëse të sigurisë nacionale apo rendit publik kërkojnë ndryshe.</p>	<p>2. Temporary residence under paragraph 1. of this Article may be granted for the time the temporary residence for the parent or guardian of a child is permitted or up to one year, if one of the parents or guardian have a permanent residence permit.</p> <p style="text-align: center;">Article 46 Period of validity of a temporary residence</p> <p>1. Temporary residence permit is issued for a period of one year unless otherwise is specified under this law.</p> <p>2. The period of validity of the travel document must be at least 3 months longer than the period for which the temporary residence permit is issued.</p> <p>3. Residence permit for persons enjoying refugee status will be issued with a validity of at least 3 years and renewable unless compelling reasons of national security or public order otherwise require.</p>	<p>deteta.</p> <p>2. Privremeni boravak iz stava 1 ovog člana može se dati roditelju ili staratelju deteta dok im bude dozvoljeno da ostanu privremeno ili do 1 godine, u slučaju da je jedan od roditelja ili staratelja ima stalnu dozvolu boravka.</p> <p style="text-align: center;">Član 46 Vremenski period validnosti privremenog boravka</p> <p>1. Boravišna privremena dozvola za privremeni boravak odobrice se u trajanju od godinu dana, osim ako zakonom nije drukčije određeno.</p> <p>2. Period važenja putne isprave mora biti najmanje 3 meseca duže od perioda za koji se izdaje dozvola za privremeni boravak.</p> <p>3. Boravišna dozvola za lica koja uživaju status izbeglice izdaje se na period od tri godine i može se obnoviti, osim ako postoje naročito važni razlozi nacionalne bezbednosti ili javnog poretka koje zahtevaju drugacije.</p>
---	--	---



Neni 47 Vazhdimi i lejeqëndrimit të përkohshëm	Article 47 Extension of a temporary residence permit	Član 47 Produženje dozvole zaprivremeni boravak
<p>1. Kërkesa për vazhdimin e lejes së qëndrimit të përkohshëm duhet të paraqitet jo më vonë se 30 ditë para skadimit të lejeqëndrimit të përkohshëm në DSHAM.</p> <p>2. I huaji i cili ka paraqitë kërkesën për vazhdimin e lejes së qëndrimit të përkohshëm para skadimit të qëndrimit të përkohshëm ekzistues mund të qëndrojë në Republikën e Kosovës deri në vendosje lidhur me kërkesën.</p> <p>3. Përfundimisht nga neni 46, paragrafin 2. të këtij ligji, i huaj që nuk posedon një dokument udhëtimi të vlefshëm, dhe i cili parashtron kërkesë për vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm në Republikën e Kosovës, i lëshohet një vendim për miratimin e lejeqëndrimit të përkohshëm.</p> <p>4. I huaji nga paragrafi 3 i këtij neni, i cili parashtron kërkesë për vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm duhet t'ia bashkëngjijë dokumentin e huaj të udhëtimit.</p> <p>5. I huaji me lejeqëndrim të përkohshëm</p>	<p>1. Application for extension of a temporary residence permit must be submitted no later than 30 days before the expiration of a temporary residence permit at DCAM.</p> <p>2. A foreigner who has submitted an application for the extension of temporary residence permit before the expiration of the existing temporary residence may residence in the Republic of Kosovo till the application shall be decided upon.</p> <p>3. Without prejudice to Article 46 paragraph 2. of the law, a foreigner who does not possess a valid travel document, and who submits an application for extension of a temporary residence permit in the Republic of Kosovo, shall be issued a decision for the approval of a temporary residence permit.</p> <p>4. A foreigner from paragraph 3. of the present Article, which submits an application for the extension of a temporary residence permit must attach the foreign travel document.</p> <p>5. A foreigner with a temporary residence</p>	<p>1. Zahtev za produženje dozvole za privremeni boravak mora da se podnese u DDAM, najkasnije 30 dana pre isteka privremene boravišne dozvole.</p> <p>2. Strancu koji je podneo zahtev za produženje privremenog boravka pre isteka postojeće dozvole za privremeni boravak, mogu da ostanu u Republiku Kosovo, dok se ne donese odluka o njihovom zahtevu.</p> <p>3. Bez obzira na član 46 stav 2. ovog zakona, stranac koji ne poseduje važeću putnu ispravu, a koji podnese zahtev za produženje privremenog boravka u Republici Kosovo, za njega se izdaje odobrenje odluka za Privremeni boravak.</p> <p>4. Stranac iz stava 3 ovog člana, koji podnese zahtev za produženje privremenog boravka, mora podneti sopstvenu putnu ispravu za strance.</p> <p>5. Stranac koji ima privremeni boravak,</p>



<p>mund të parashtojë një kërkesë për një lejeqëndrim të radhës për një qëllim tjetër, para skadimit të periudhës për të cilën është lëshuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 48 Kushtet për dhënien e lejeqëndrimit të përkohshëm</p> <p>1. Të huajit do t'i jepet lejeqëndrimi i përkohshëm, nëse:</p> <ul style="list-style-type: none">1.1. dëshmon qëllimin e qëndrimit të përkohshëm;1.2. posedon dokument të vlefshëm udhëtimi;1.3. posedon mjete të mjaftueshme për jetesë;1.4. posedon sigurim shëndetësor;1.5. nuk ka ndalesë të hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës;1.6. nuk përbën kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik ose shëndetin publik.	<p>permit may, prior to the expiry of the period for which the permit was issued, lodge an application for a subsequent residence permit for a different purpose.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 Conditions for issuing a temporary residence permit</p> <p>1. A foreigner shall be issued a temporary residence permit, if:</p> <ul style="list-style-type: none">1.1. proves the purpose of temporary residence;1.2. is in possession of a valid travel document;1.3. is in possession of sufficient means of subsistence;1.4. is in possession of medical insurance;1.5. has no entry and residence ban in the Republic of Kosovo;1.6. constitutes no threat to state security, public order or public health.	<p>moze da pre isteka perioda za koji se izdaje dozvola za privremeni boravak, da zatraži narednu dozvolu za privremeni boravak za druge namene.</p> <p style="text-align: center;">Član 48 Uslovi za izdavanje dozvole za privremeni boravak</p> <p>1. Strancu se izdaje dozvola za privremeni boravak ako:</p> <ul style="list-style-type: none">1.1. dokaze namere za privremeni boravak;1.2. poseduju važeću putnu ispravu;1.3. poseduju dovoljno finansijskih sredstava za život;1.4. ima zdravstveno osiguranje;1.5. ne postoji zabrana ulaska i boravka u Republici Kosovo;1.6. ne predstavljaju opasnost po nacionalnu bezbednost, javni poredak ili javno zdravlje.
--	---	---



Neni 49 Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar	Article 49 Temporary residence permit for the purpose of family reunification	Član 49 Privremeni boravak radi spajanja porodice
<p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar mund t'i jepet një të huaji i cili është anëtar i ngushtë i familjes:</p> <p>1.1. i shtetasit të Kosovës;</p> <p>1.2. i të huajit i cili ka lejeqëndrim të përhershëm;</p> <p>1.3. i të huajit i cili ka të lejeqëndrim të përkohshëm;</p> <p>1.4. i të huajit të cilit i është dhënë mbrojtje në pajtim me Ligjin për Azil.</p> <p>2. Pavarësisht nga paragrafi 1. nënparagrafi 1.3. i këtij neni, anëtarit të ngushtë të familjes së të huajit i cili qëndron në Republikën e Kosovës në bazë të lejeqëndrimit të përkohshëm për punë të lëshuar për një vit, në përputhje me kuotat vjetore për punësimin e të huajve, mund t'i jepet lejeqëndrim i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar, vetëm nëse i huaji</p>	<p>1. A temporary residence permit for the purpose of family reunification may be granted to a foreigner who is a close family member:</p> <p>1.1. of a citizen of Kosovo;</p> <p>1.2. of the foreigner who is in possession of a permanent residence permit;</p> <p>1.3. of the foreigner who is in possession of a temporary residence permit;</p> <p>1.4. of a foreigner who has been granted international protection in accordance with the Law on Asylum.</p> <p>2. Irrespective of paragraph 1. sub-paragraph 1.3. of this Article, a close family member of a foreigner who is residenceing in the Republic of Kosovo on the basis of a temporary residence permit for employment issued for one year, pursuant to annual quotas for the employment of foreigners, may be granted a temporary residence permit for the purpose of family reunification, if the</p>	<p>1. Dozvola za privremeni privremeni boravak radi spajanja porodice može se odobriti strancu koji je član uže porodice:</p> <p>1.1. građanin Kosova;</p> <p>1.2. Stranac koji ima dozvolu za stalni boravak;</p> <p>1.3. Stranac koji ima dozvolu za privremeni boravak;</p> <p>1.4. stranac kome je odobrena međunarodna zaštita u skladu sa Zakonom o azilu.</p> <p>2. Bez obzira na stav 1 tačka 1.3. ovog člana, članu uže porodice stranca, koji je nastanjen u Republici Kosovo, na osnovu privremene boravišne dozvole za izdavanje radne dozvole koja se izdaje za ovu prvu godinu, na osnovu godišnjih kvota zapošljavanje stranaca, može se dati za privremeni boravak radi spajanja porodice, i ukoliko stranac podnese</p>



<p>kërkon bashkim familjar në Republikën e Kosovës dhe nëse i ka të paktën 2 vjet të qëndrimit të përkohshëm.</p> <p>3. Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar nuk do t'i jepet për një anëtar të familjes së të huajit të cilit i është lëshuar lejeqëndrimi për punë sezonale, azilkërkuesve dhe të huajve nën mbrojtje të përkohshme.</p> <p>4. Parashtrimi i kërkesës për qëllim të këtij neni do të dorëzohet dhe shqyrtohet kur anëtarët e familjes janë duke qëndruar në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>5. Kur bëhet shqyrtimi i kërkesës, interesat më të mira të fëmijëve të mitur do të merren parasysh.</p> <p style="text-align: center;">Neni 50 Anëtarët e familjes</p> <p>1. Anëtarët e familjes në kuptimin të këtij ligji janë:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. bashkëshortët e sponzorit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. fëmijët e mitur të sponzorit dhe të</p>	<p>foreigner seeks family reunification in the Republic of Kosovo, and if he/she has at least 2 years of temporary residence.</p> <p>3. Temporary residence for the purpose of family reunification shall not be given to a family member of a foreigner who has been issued a residence permit for seasonal work, asylum seekers and to foreigners under temporary protection.</p> <p>4. The application for the purpose of this article shall be submitted and examined when the family members are residing outside the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>5. When examining the application the best interests of the minor children shall be taken into consideration.</p> <p style="text-align: center;">Article 50 Family members</p> <p>1. Family members in the meaning of this law are:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. the sponsor's spouses;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. the minor children of the sponsor</p>	<p>zahtev za spajanje porodice u Republike Kosovo, i ako on / ona ima najmanje 2 godine privremenog boravka.</p> <p>3. Privremeni boravak radi spajanja porodice neće se dati članu porodice stranca kome je izdata boravišna dozvola za sezonski rad, azilantima i strancima pod privremenom zaštitom.</p> <p>4. Zahtev za potrebe ovog člana, treba da se podnosi i ispituje kada članovi porodice borave van teritorije Republike Kosovo.</p> <p>5. Prilikom razmatranja zahteva ce biti uzeti u obzir najbolji interesi maloletne dece.</p> <p style="text-align: center;">Član 50 Članovi porodice</p> <p>1. članovi porodice u smislu ovog zakona su:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. supružnici sponzora i;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. su maloletna deca sponzora i</p>
--	---	---



<p>bashkëshortit të tij/saj, duke përfshirë fëmijët e adoptuar në pajtim me vendimin e marrë nga autoriteti i Republikës së Kosovës, apo një vendim i cili është automatikisht i zbatueshëm për shkak të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, apo duhet të njihen në pajtim me detyrimet ndërkombëtare;</p> <p>1.3. fëmijët e mitur duke përfshirë fëmijët e sponsorit kur sponsori ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur në të. Ribashkimi familjar mund të autorizohet për fëmijët kujdestaria e të cilëve është e ndarë, me kusht që pala tjetër që e ndan kujdestarinë ka dhënë pajtimin e tij apo saj;</p> <p>1.4. fëmijët e mitur duke përfshirë fëmijët e adoptuar të bashkëshortit kur bashkëshorti ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur në të. Ribashkimi familjar mund të autorizohet për fëmijët kujdestaria e të cilëve është e ndarë, me kusht që pala tjetër e cila ndanë kujdestarinë ka dhënë pajtimin e tij apo saj.</p> <p>2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij Neni, autoriteti kompetent mund të</p>	<p>and of his/her spouse, including children adopted in accordance with a decision taken by the authority in the Republic of Kosovo, or a decision which is automatically enforceable due to international obligations of the Republic of Kosovo, or must be recognized in accordance with international obligations;</p> <p>1.3. The minor children including adopted children of the sponsor where the sponsor has custody and the children are dependent on him or her. Family reunification may be authorized for children of whom custody is shared, provided that the other party sharing custody has given his or her agreement;</p> <p>1.4. the minor children including adopted children of the spouse where the spouse has custody and the children are dependent on him or her. Family reunification may be authorized for children of whom custody is shared, provided that other party sharing custody has given his or her agreement.</p> <p>2. Notwithstanding the paragraph 1 of this Article, the competent authority may</p>	<p>njegovog / njenog bračnog druga, uključujući i decu koja su usvojena u skladu sa odlukom vlasti u Republici Kosovo, ili odluke koje je izvršna automatski zbog međunarodnih obaveza Republike Kosovo, ili mora se priznaju u skladu sa međunarodnim obavezama;</p> <p>1.3. Maloletna deca, uključujući usvojena deca sponzora gde sponzor ima starateljstvo i deca zavise od njega ili nje. Republika Kosovo može odobriti spajanje dece od kojih je podeljeno starateljstvo, pod uslovom da starateljstvo je podeljeno uz sporazum;</p> <p>1.4. maloletne dece, uključujući usvojene dece supružnika gde supružnik ima starateljstvo i deca zavise od njega ili nje, Republika Kosovo može odobriti spajanje dece od kojih je podeljeno starateljstvo, pod uslovom da druga strana deljenje pritvor je dao njegov sporazum.</p> <p>2. Izuzetno od stava 1 ovog člana, nadležni organ može da razmotri člana</p>
---	--	---



<p>konsiderojë gjithashtu anëtarin e familjes se shtetasit të Kosovës, të huajt të cilit i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm apo i përhershëm, dhe të huajt i cili ka statusin e azilit, nëse ka arsye të veçanta personale apo serioze humanitare për ribashkim familjar në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Në rastin e një martese poligame, kur sponsori tashme ka një bashkëshort që jeton me të në territorin e Republikës së Kosovës nuk do të autorizohet ribashkimi familjar me një bashkëshort të mëvonshëm.</p> <p>4. Ribashkimi familjar nuk do të jepet nëse bashkëshorti ose nëse partneri jashtëmartesor është i martuar ose është në një marrëdhënie afatgjatë me një person tjetër.</p> <p>5. Bashkëjetesa në kuptim të këtij ligji është bashkësia jetësore e një burri të pamartuar dhe një gruaje të pamartuar që jetojnë së bashku dhe e cila zgjatë së paku 3 vjet ose më pak nëse në këtë bashkëjetesë ka lindur një fëmijë i përbashkët.</p> <p>6. Fëmijët e mitur duhet të jenë në moshë me të vogël se moshja e madhorisë dhe nuk duhet të jenë të martuar.</p>	<p>consider also family member of a citizen of Kosovo, of a foreigner to whom has been granted temporary or permanent residence, and of a foreigner who has the asylum status, if there are special personal or serious humanitarian reasons for a family reunification in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. In the event of a polygamous marriage, where the sponsor already has a spouse living with him in the territory of the Republic of Kosovo shall not authorize the family reunification of a further spouse.</p> <p>4. Family reunification shall not be granted if the spouse or unmarried partner is married or is in a long-term relationship with another person.</p> <p>5. Partnership in the meaning of this law is a partnership of an unmarried man and an unmarried woman living together and which lasts at least 3 years or less if in this partnership was born a child of both of them.</p> <p>6. Minor children must be below the age of majority and must not be married.</p>	<p>porodice državljanina Kosova, strancu kome je odobren privremeni ili stalni boravak, i za stranca koji ima status azilanta, ako postoje posebni lični ili ozbiljni humanitarni razlozi za spajanje porodice u Republici Kosovo.</p> <p>3. U slučaju poligamijskog braka, gde sponzor već ima supružnika živi sa njim na teritoriji Republike Kosovo se neće odobriti spajanje porodice za drugog supružnika.</p> <p>4. Spajanje porodice neće se odobriti ako je supružnik ili nevenčani partner u braku ili je u dugoj vezi sa drugom osobom.</p> <p>5. Partnerstvo u smislu ovog zakona jeste partnerstvo neoženjenog muškarca i udate žene koji žive zajedno i koji ima najmanje 3 godine ili manje, ako u ovom partnerstvu je rođeno dete od njih oboje.</p> <p>6. Maloletna deca moraju biti mlađi od većine i ne mora biti u braku.</p>
--	---	--



<p>7. Si përjashtim, nëse fëmija është në moshë mbi 12 vjeçare dhe arrin në mënyrë të pavarur nga pjesa tjetër e familjes së tij/saj, Republika e Kosovës mund, para se të autorizojë hyrjen dhe qëndrimin sipas këtij ligji, të verifikojë nëse ai ose ajo e plotëson kushtin për integrim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 51 Ndëshkimet dhe rishqyrtimi</p> <p>1. DSHAM mund të refuzojë një kërkesë për hyrje dhe qëndrim për qëllim të ribashkimit familjar, apo, nëse është e duhur, revokon apo refuzon ta ripërtërijë lejeqendrimin e anëtarit të familjes, në rrethanat si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 Kur kushtet e përcaktuara me këtë ligj nuk janë plotësuar apo nuk plotësohen më tej. Kur ripërtërihet një leje qëndrim, në rast se sponsori nuk ka mjete të mjaftueshme pa pasur qasje në sistemin e asistencës sociale të Republikës së Kosovës, do të merren parasysh kontributet e anëtareve të familjes në ekonominë familjare;</p>	<p>7. By way of derogation, the child is aged over 12 years and arrives independently from the rest of his/her family, the Republic of Kosovo may, before authorizing entry and residence under this law, verify whether he or she meets a condition for integration provided for by its existing legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 51 Penalties and redress</p> <p>1. DCAM may reject an application for entry and residence for the purpose of family reunification, or, if appropriate, withdraw or refuse to renew a family member's residence permit, in the following circumstances:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. when the conditions defined by this law are not or no longer will be fulfilled. When renewing the residence permit, when the sponsor has not sufficient resources without recourse without having access to the social assistance system of the Republic of Kosovo. Account shall be taken to the contributions of the family members to the family economy;</p>	<p>7. Izuzev ako je dete je staro preko 12 godina i dolazi nezavisno od ostatka njegove/njene porodice, Republika Kosovo mogu, pre nego što odobri ulazak i boravak u skladu sa ovim zakonom, proveriti da li je on ili ona ispunjava uslov za integraciju pod uslovom za po postojećim zakonima na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 51 Kazne i ponovno razmatranje</p> <p>1. DDAM može odbiti zahtev za ulazak i boravak radi spajanja porodice, ili, ako je potrebno, povuče ili odbije produženja dozvole boravka članu porodice u sledećim okolnostima:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. kada uslovi propisani ovim zakonom nisu ispunjeni ili više se ne ispunjavaju. Prilikom obnavljanja dozvola boravka, a sponzor nema dovoljno sredstava bez pristupa u sistemu socijalne pomoći Republike Kosovo. Uzeće se u obzir u doprinosu članova porodice prihodima domaćinstva;</p>
--	--	--



<p>1.2. Kur sponsori dhe anëtari i familjes se tij/saj nuk jeton apo nuk jeton më në një marrëdhënie të vërtetë martesore apo familjare;</p> <p>1.3. Kur gjendet se sponsori apo partneri i pamartuar është i martuar apo është në një marrëdhënie stabile afatgjate me një person tjetër.</p> <p>2. DSHAM mund gjithashtu të refuzojë një kërkesë për hyrje dhe qëndrim për qëllim të ribashkimit familjar, apo revokon apo refuzon të ripërtërijë lejeqëndrimin e anëtarit të familjes, kur shihet se:</p> <p>2.1. janë përdorur informacione të falsifikuara apo mashtruese, dokumente false apo të falsifikuara, mashtrimi ishte kryer apo mjete të tjera të kundërligjshme ishin përdorur;</p> <p>2.2. martesë, marrëdhënia jashtëmartesore apo adoptimi ishin kontraktuar me qëllim të vetëm të lejimit të personit të hyjë apo qëndrojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Kur e bene vlerësimin në lidhje me këtë çështje, DSHAM mund të marrë parasysh në veçanti faktin se martesë, bashkësia jashtëmartesore apo adoptimi ishin kontraktuar pas lëshimit të</p>	<p>1.2. when the sponsor and his/her family member do not or no longer live in a real marital or family relationship;</p> <p>1.3. when it is found that the sponsor or the unmarried partner is married or is in a stable long-term relationship with another person.</p> <p>2. DCAM may also reject an application for entry and residence for the purpose of family reunification, or withdraw or refuse to renew the family member's residence permits, where it is shown that:</p> <p>2.1. false or misleading information, false or falsified documents were used, fraud was committed or other unlawful means were used;</p> <p>2.2. the marriage, extramarital relationship or adoption were contracted for the sole purpose of enabling the person concerned to enter or reside in the territory of the Republic of Kosovo. When making an assessment related to this issue, DCAM may have regard in particular to the fact that the marriage, extramarital relationship or adoption was</p>	<p>1.2. kada sponzor i član njegove / njene porodice ne živi ili više ne živi u stvarnom porodičnom odnosu;</p> <p>1.3. kada se utvrdi da je sponzor ili nevenčani partner u braku ili u stabilnoj dugoj vezi sa drugom osobom.</p> <p>2. DDAM takođe može odbiti zahtev za ulazak i boravak radi spajanja porodice, ili povuku ili odbiju da obnove dozvole članu porodice, gde je pokazala da:</p> <p>2.1. lažne ili falsifikovane informacije, lažnih ili falsifikovana dokumenata su optrebljeni, počinjena je prevara ili drugim protivpravnim sredstvima su korišćeni;</p> <p>2.2. brak, vanbračna veza ili usvojenje je ugovoren sa jednim ciljem omogućavanja lica ulazak ili boravi na teritoriji Republike Kosovo. Kada se vrši procena u vezi sa ovim pitanjem, DDAM može uzeti u obzir posebno činjenicu da brak, vanbračna veza ili usvojenje je ugovoreno nakon izdavanja</p>
---	--	---



<p>lejeqëndrimin për sponsorin.</p> <p>3. DSHAM mund të revokojë apo refuzojë të ripërtërijë lejeqëndrimin për anëtarin e familjes kur lejeqëndrimi i sponsorit skadon dhe anëtari i familjes akoma nuk e gëzon lejeqëndrimin autonom të qëndrimit sipas Nenit 54 të këtij ligji.</p> <p>4. DSHAM mund të kryejë kontrollime specifike dhe inspektime kur ka arsye për të dyshuar se ka mashtrim, apo martesë, marrëdhënie jashtëmartesore apo adoptimi është lidhur sipas interesit. Kontrollime specifike mund gjithashtu të ndërmerren në rast të ripërtëritjes së lejeqëndrimit të anëtarëve të familjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 52 Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm për anëtarët e familjes të të huajit që gëzojnë mbrojtje në pajtim me Ligjin për Azil</p> <p>1. Definicioni i anëtarëve të familjes i paraparë në paragrafin 1 të Nenit 51 të këtij ligji, duhet të zbatohet gjithashtu edhe për anëtarët e familjes së personave cilëve iu është dhënë mbrojtje në pajtim me Ligjin për Azilin.</p> <p>2. Anëtari i familjes të cilit iu është dhënë</p>	<p>contracted after the sponsor had been issued his/her residence permit.</p> <p>3. DCAM may withdraw or refuse to renew the residence permit of a family member when the sponsor's residence permit expires and the family member does not yet enjoy an autonomous right of residence under Article 54 of this law.</p> <p>4. DCAM may conduct specific checks and inspections when there is reason to suspect that there is fraud or a marriage, extramarital relationship or adoption of convenience as defined by paragraph 2. Specific checks may also be undertaken on the occasion of the renewal of family members' residence permit.</p> <p style="text-align: center;">Article 52 Entry and residence of family members of a foreigner which enjoys protection in accordance with Law on Asylum</p> <p>1. The definition of family members prescribed in paragraph 1 of Article 51 of this law shall be applicable as well to the family members of persons to whom is given protection in accordance with Law on Asylum.</p> <p>2. A family member who has been granted</p>	<p>boravišne dozvole za sponsor.</p> <p>3. DDAM može povući ili odbiti da obnove dozvolu za boravak člana porodice kada dozvola za boravak sponzora istekne I član porodice još uvek ne uživa autonomno pravo boravka iz člana 54.</p> <p>4. DDAM može da vrši određene provere i inspekcije kada postoji razlog za sumnju da postoji prevara ili brak, vanbračna veza ili usvojenje sa interesom kao što je definisano stavom 2. Specifične provere mogu se preduzeti povodom obnavljanja boravišne dozvole članova porodice.</p> <p style="text-align: center;">Član 52 Privremeni boravak članova porodice koji uživa zaštitu u skladu sa Zakonom o azilu</p> <p>1. Definicija članova porodice propisanim u stavu 1 člana 51 ovog zakona, primenjivace se i na članove porodice lica kojima je dato zastita u skladu sa i Zakonom o azilu.</p> <p>2. Član porodice koji su dobili zastitu u</p>
--	--	---



<p>mbrojtje ne përputhje me Ligjin për Azil, për fitimin e lejeqëndrimit të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar, nuk i kërkohet t'i përmbush kushtet e përcaktuara në Nenin 48 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të këtij ligji.</p> <p>3. Nëse të huajit të cilit i lejohet mbrojtja në përputhje me Ligjin për Azil, është i mitur i pashoqëruar, atëherë Republika e Kosovës:</p> <p>3.1 do të autorizojë hyrjen dhe qëndrimin me qëllim të ribashkimit familjar të afërmeve të tij/saj të shkallës së parë në linjë direkte të ngjitjes.</p> <p>3.2 do të autorizojë hyrjen dhe qëndrimin me qëllim të ribashkimit familjar të kujdestarit ligjor të tij/saj apo ndonjë anëtarit tjetër të familjes, kur refugjati nuk është në lidhje direkte të ngjitjes apo të afërm të tillë nuk mund të gjinden.</p> <p>4. Kur refugjati nuk mund të ofrojë dëshmi zyrtare të marrëdhënies familjare, DSHAM do të marrë parasysh dëshmi tjera, që do të vlerësohen në pajtim me legjislacionin në fuqi, të ekzistimit të marrëdhënies së tij.</p>	<p>protection in accordance with the Law on Asylum, to grant a temporary residence permit for the purpose of family reunification shall not be required to fulfill the conditions laid down in Article 49 paragraph 1. sub-paragraph 1.3. and 1.4.. of the law.</p> <p>3. If a foreigner to whom protection is granted in accordance with Law on Asylum is an unaccompanied minor, then the Republic of Kosovo:</p> <p>3.1. shall authorize entry and residence for the purposes of family reunification of his/her first-degree relatives in the direct ascending line;</p> <p>3.2. shall authorize the entry and residence for the purposes of family reunification of his/her legal guardian or any other member of the family, where the refugee has no in the direct ascending line or such relatives cannot be traced.</p> <p>4. Where a refugee cannot provide official documentary evidence of the family relationship, the DCAM shall take into account other evidence, to be assessed in accordance with national legislation, of the</p>	<p>skladu sa Zakonom o Azilu, za odobrenje privremen boravisne dozvole radi spajanja porodice, ne treba ispunjavati uslove propisane u clanu 48 stava 1, podstava 1.3 i 1.4 ovog zakona.</p> <p>3. Ukoliko stranac kome je zaštita dodeljena u skladu sa Zakonom o azilu je bez pratnje, tada Republika Kosovo:</p> <p>3.1 . odobrava ulazak i boravak u svrhu spajanja porodice njegove / njene prvo koleno u direktnoj uzlaznoj liniji;</p> <p>3.2 . će odobriti ulazak i boravak u svrhu spajanja porodice njegovog / njenog zakonskog zastupnika ili bilo koji drugi član porodice, u kojoj nema izbeglica u direktnoj uzlaznoj liniji, odnosno srodnici takvih ne može pratiti.</p> <p>4. Kada izbeglica ne može da obezbedi zvanično dokumentovani dokaz o porodičnim odnosima, DDAM će uzeti u obzir i druge dokaze mogu se proceniti u skladu sa nacionalnim</p>
--	---	--



<p>Vendimi me te cilin refuzohet kërkesa nuk mund të bazohet vetëm ne faktin se dëshmia dokumentuese mungon.</p> <p style="text-align: center;">Neni 53 Vlefshmëria e lejeqëndrimit të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar jepet për një afat vlefshmërie prej një viti ose deri në skadimin e qëndrimit të përkohshëm të lejuar të huajit i cili kërkon ribashkimin familjar.</p> <p>2. I huaj i cili më parë ka pasur lejeqëndrim të vazhdueshëm të qëndrimit të përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar për të paktën 2 vjet, lejeqëndrimi i përkohshëm për të njëjtin qëllim mund të jepet për një periudhë deri në dy vjet, ose deri në skadimin e lejeqëndrimit të përkohshëm i të huajit me të cilin është kërkuar ribashkimi familjar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 54 Qëndrimi autonom</p> <p>1. Bashkëshortit, bashkëshortit</p>	<p>existence of such relationship. A decision rejecting an application can not be based solely on the fact that documentary evidence is lacking.</p> <p style="text-align: center;">Article 53 Validity of a temporary residence permit for the purpose of family reunification</p> <p>1. A temporary residence permit for the purpose of family reunification shall be given for a period of time valid of one year or until the expiration of the temporary residence permit to a foreigner who requests that family reunification.</p> <p>2. A foreigner who previously had a continuous temporary residence permit for the purpose of family reunification for at least 2 years, a temporary residence permit for the same purpose may be granted for a period of up to two years, or until the expiration of the temporary residence permit of the foreigner who is seeking family reunification.</p> <p style="text-align: center;">Article 54 Autonomous residence</p> <p>1. To spouse, unmarried partner and the child</p>	<p>zakonodavstvom, o postojanju takvog odnosa. Rešenje kojim se odbija zahtev ne može da se zasniva samo na činjenici da dokumentarni dokazi nedostaje.</p> <p style="text-align: center;">Član 53 Validnost dozvole za privremeni boravak sa ciljem porodicnog spajanja</p> <p>1. Dovolja za privremeni boravak radi spajanja porodice odobrava se sa rokom važenja od jedne godine ili do isteka privremenog boravka za jednog stranca koji podnosi zahtev za spajanje porodice.</p> <p>2. Stranac koji je u prošlosti imao privremenu dozvolu boravka u svrhu spajanja porodica nastavlja da najmanje dve godine, privremeni boravak za istu svrhu može da se izdaje na period do dve godine, ili do isteka privremenog boravka strancu koji podnosi zahtev za spajanje porodice.</p> <p style="text-align: center;">Član 54 Autonomni boravak</p> <p>1. Suprugu, suprugu vanbračne veze i</p>
--	--	---



<p>jashtëmartetor dhe fëmiut i cili ka arritur moshën madhore, mund t'i jepet lejeqëndrim autonom, nëse ai plotëson kushtet nga nenit 48 paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. dhe 1.6. të këtij ligji, në qoftë se atij i është dhënë lejeqëndrim i përkohshëm për qëllime të ribashkimit familjar për një periudhë të vazhdueshme prej 3 vitesh.</p> <p>2. Përfundimisht, një të huaji nga paragrafi 1. i këtij neni mund t'i jepet një qëndrim autonom nëse ai plotëson kushtet nga nenit 48, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. dhe 1.6 të këtij ligji dhe nëse atij/asaj i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar për një periudhë të vazhdueshme prej 2 vitesh dhe në rast se personi në bazë të së cilës atij i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar, ka vdekur.</p> <p>3. Përfundimisht, lejeqëndrimi autonom mund të lëshohet pas parashtrimit të kërkesës së personave që kanë hyrë në bazë të ribashkimit familjar, veçushisë, shkurorëzimit dhe ndarjes.</p>	<p>who has reached the age of majority, may be granted an autonomous residence permit, if it meets the conditions referred to in article 48 paragraph 1. subparagraph 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. and 1.6. of this law, in the event to him/her has been granted a temporary residence permit for the purpose of family reunification for a continuous period of 3 years.</p> <p>2. Exceptionally, a foreigner from paragraph 1. of this Article may be granted an autonomous residence if it meets the conditions referred to in article 48 paragraph 1. subparagraph 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. and 1.6. of this law, and in the event he/she is granted of a temporary residence permit for the purpose of family reunification for a continuous period of 2 years, if the person on the basis of which he/she was granted a temporary residence permit for the purpose of family reunification, has died.</p> <p>3. Exceptionally, autonomous residence may be issued upon application to persons who have entered by virtue of family reunification, in the event of widowhood, divorce, separation.</p>	<p>detu koje je navršilo doba maloletništva, može se odobriti autonomni boravak ako ispunjavaju uslovi iz člana 48 stav 1 tačka 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. i 1.6. ovog zakona, ako njemu je zdato dozvola za privremeni boravak radi spajanja porodice u kontinuiranom periodu od 3 godine.</p> <p>2. Izuzev, stranac iz stava 1 ovog člana može steći autonomni boravak, ako ispunjava uslove iz člana 48, stav 1, tačka 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. i 1.6. ovog zakona, a ako je njemu izdata boravišna dozvola za privremeni boravak za spajanje porodice u neprekidnom trajanju od dve godine, ako je lice na osnovu koje je njemu izdata dozvola za privremeni boravak radi spajanja porodice, je umro.</p> <p>3. Izuzev, dozvola autonomni boravak se izdaje, na zahtev lica koji su ušli preko spajanja porodice, u slučaju udovištva, razvod, odvajanja.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 55</p> <p style="text-align: center;">Të drejtat e të huajve me qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar dhe qëndrimit autonom</p> <p>Të huajt të cilit i është dhënë lejeqëndrim i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar dhe të huajt me qëndrim autonom nga neni 54 i këtij ligji, gëzon të drejtën për shkollim, aftësim profesional, punë dhe vetëpunësim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 55</p> <p style="text-align: center;">Rights of a foreigner with a temporary residence for the purpose of family reunification and autonomous residence</p> <p>A foreigner to whom a temporary residence permit has been granted for the purpose of family reunification and a foreigner with autonomous residence referred to in Article 54 of this law, enjoys the rights to education, vocational training, work and self-employment.</p>	<p style="text-align: center;">Član 55</p> <p style="text-align: center;">Prava stranca sa privremenom boravišnom sozvolom, sa ciljem spajanja porodice i autonomnim boravkom</p> <p>Strancu kome je izdata dozvola o privremenom boravku, radi spajanja porodice i stranac sa autonomnim boravkom iz člana 54 ovog zakona, imaju pravo na obrazovanje, stručno osposobljavanje, zapošljavanje i samozapošljavanje</p>
<p style="text-align: center;">Neni 56</p> <p style="text-align: center;">Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimit parauniversitar</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të arsimit parauniversitar, do t'i jepet një të huaji i cili krahas kushteve nga neni 48, i këtij ligji, përmbushë edhe kushtet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">1.1. është regjistruar në institucionin arsimor;1.2. merr pjesë në një program të shkëmbimit të nxënësve të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsim;1.3. paraqet pëlqimin e prindërve ose kujdestarit ligjor për qëndrimin e	<p style="text-align: center;">Article 56</p> <p style="text-align: center;">Temporary residence for the purpose of secondary education</p> <p>1. A temporary residence permit for the purpose of secondary education shall be granted to a foreigner who besides the conditions referred to in article 48 of the law shall meet the following conditions as well:</p> <ul style="list-style-type: none">1.1. is enrolled in a secondary school;1.2. participates in a student exchange program approved by the responsible ministry for education;1.3. presents the consent of the parents or of the legal guardian for the scheduled	<p style="text-align: center;">Član 56</p> <p style="text-align: center;">Privremeni boravak zbog srednjoškolskog obrazovanja</p> <p>1. Dozvolu za privremeni boravak radi srednjoškolskog obrazovanja će imati stranac koji, pored uslova iz člana 48 ovog zakona, ispunjava uslove navedene u nastavku i:</p> <ul style="list-style-type: none">1.1. upisuje se u srednju školu;1.2. učestvuje u programu razmene za studente, odobrene od strane nadležnog ministarstva obrazovanja;1.3. predstavlja saglasnost roditelja ili staratelja za planirani boravak, što



<p>planifikuar, qëllimi i së cilës është arsimimi parauniversitar në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.4. ofron dëshmi se organizata e cila udhëheq programin e shkëmbimit të nxënësve është përgjegjëse për atë gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës, veçanërisht në lidhje me mjetet e jetesës, të mësuarit, kujdesin shëndetësor dhe shpenzimet e kthimit dhe</p> <p>1.5. familja tek e cila ai banon ligjshëm i përmbush kushtet në bazë të dispozitave të veçanta dhe është zgjedhur në bazë të programit të këmbimit të nxënësve.</p> <p>2. Leje qëndrimi i përkohshëm për qëllime të arsimit parauniversitar lëshohet me afat vlefshmërie deri në një vit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 57 Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimit të lartë</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimit të lartë do t'i jepet një të huaj i cili i plotëson kushtet nga nenit 48 i këtij ligji dhe plotëson kushtet e mëposhtme:</p>	<p>residence whose objective is secondary education in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4. provides evidence that the organization which manages the student exchange program is responsible for him/her during his/her residence in the Republic of Kosovo, particularly in relation to the means of living, learning, and health care and returning costs and</p> <p>1.5. the family to which he/she legally resides is eligible in accordance with specific provisions and is selected based on the student exchange program.</p> <p>2. A temporary residence permit for the purpose of secondary education shall be issued with a validity period of up to one year.</p> <p style="text-align: center;">Article 57 Temporary residence for the purpose of study</p> <p>1. A temporary residence permit for the purpose of study shall be granted to a foreigner who meets the requirements of article 48 of the Law and the following conditions:</p>	<p>je cilj srednjeg obrazovanja u Republici Kosovo;</p> <p>1.4.pruži dokaz da je organizacija, koja upravlja programom za upravljanje studenata je odgovoran za njega / nju da ostanu u Republici Kosovo, naročito u odnosu na sredstva za život, učenje i zdravstvene zaštite i troškova povratka i</p> <p>1.5. Porodica u kojoj on legalno boravi je prihvatljiva i u skladu sa posebnim propisima i odabranih na osnovu programa razmene studenata.</p> <p>2.Dozvola za privremeni boravak radi srednjoškolskog obrazovanja izdaje se sa rokom važenja do jedne godine.</p> <p style="text-align: center;">Član 57 Dozvola za privremeni boravak zbog studiranja</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak radi studiranja će se dati strancu koji ispunjava uslove iz člana 48 ovog zakona, i predstavila sledeće uslove:</p>
---	---	---



<p>1.1. studion në një institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.2. vjen në kuadër të shkëmbimit të studentëve dhe lëvizshmërisë së të rinjëve;</p> <p>1.3. vjen në praktikë të autorizuar nga organizata apo në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërmjet universiteteve.</p> <p>2. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim arsimit të lartë lëshohet me afat vlefshmërie deri në një vit, ose deri në fund të vitit akademik.</p> <p>3. Kryerja e praktikës e të huajit nga paragrafi 1. i këtij neni nuk do të konsiderohet si punë në kuptim të dispozitave të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 58 Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të kërkimit shkencor</p> <p>1. Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të kërkimit shkencor do t'i jepet të huajit i cili ka marrëveshje me një institucion të licencuar në Republikën e Kosovës për vizitë dhe plotëson kushtet e nenit 48 i këtij</p>	<p>1.1. studies at a higher education institution in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. comes under an exchange of students and youth mobility;</p> <p>1.3. comes for an internship authorized by an organization or on the basis of international agreements or agreements between the universities.</p> <p>2. A temporary residence permit for the purpose of study shall be issued with a period of validity of up to one year, or until the end of the academic year.</p> <p>3. Performing of an internship of a foreigner referred to in paragraph 1. of this law shall not be considered as work in terms of the provisions of the law.</p> <p style="text-align: center;">Article 58 Temporary residence for the purpose of scientific research</p> <p>1. A temporary residence for the purpose of scientific research shall be granted to a foreigner who has an agreement with a institution licenced in the Republic of Kosovo for a visit and meets the</p>	<p>1.1. studira na visokoškolske ustanove u Republici Kosovo;</p> <p>1.2. dolazi preko programa za razmenu studenata i omladinskih pokreta;</p> <p>1.3. dolazi preko nekog intersipa od ovlašćene organizacije ili na osnovu međunarodnih ugovora ili sporazuma zaključenih između univerziteta.</p> <p>2. Dozvola za privremeni boravak u cilju studiranja će se izdati sa validitetom od godinu dana, odnosno do kraja školske godine.</p> <p>3. Izvođenje prakse od stranca, iz stava 1 ovog člana neće se smatrati rad u smislu odredaba ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 58 Privremeni boravak u svrhu naučnog istraživanja</p> <p>1. Privremeni boravak u svrhu naučnog istraživanja će se dati strancu koji ima sporazum za posetu sa jednom licenciranom institucijom u Republici Kosovo, kao i da ispunjava uslove</p>
---	---	---



<p>ligji.</p> <p>2. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të kërkimeve shkencore lëshohet me afat vlefshmërie deri në një vit.</p> <p>3. I huaji i cili ka marrëveshje me qëllim të kërkimeve shkencore me ndonjërin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian apo shtetet të cilat janë pjesë e zonës Schengen, mund të qëndroj me qëllim të kërkimeve shkencore deri në 90 ditë në Republikën e Kosovës pa marrëveshje sipas paragrafit 1. të këtij neni me kusht që t'i plotësojë kushtet nga neni 48 i këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 59 Qëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare</p> <p>1. Qëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare do t'i jepet një të huaji në rastet e mëposhtme:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. nëse ai/ajo është viktimë e trafikimit me njerëz dhe ka pranuar programin e ndihmës dhe mbrojtjes;</p>	<p>requirements of article 48 of the Law.</p> <p>2. A temporary residence permit for the purpose of scientific research shall be issued with a period of validity of up to one year.</p> <p>3. A foreigner who has an agreement for the purpose of scientific research with any of the European Union Member States or States which are part of the Schengen area may reside for the purpose of scientific research up to 90 days in the Republic of Kosovo without an agreement referred to in paragraph 1. of this Article provided that they fulfill the conditions of article 48 of the law.</p> <p style="text-align: center;">Article 59 Temporary residence on humanitarian grounds</p> <p>1. A temporary residence on humanitarian grounds shall be granted to a foreigner as in the following cases:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. if he/she is a victim of human trafficking (hereinafter victim) and has accepted the assistance and protection program;</p>	<p>propisane članom 48 ovog zakona.</p> <p>2. Dozvola za privremeni boravak u svrhu obavljanja naučnog istraživanja će se izdati sa važećim periodom do jedne godine.</p> <p>3. Stranac koji ima ugovor za potrebe naučnih istraživanja sa bilo kojom državom koja je članica Evropske Unije ili državama koje su deo Šengenskog prostora može ostati u svrhe naučnih istraživanja u Republici Kosovo do 90 dana bez dogovora pomenuto u članu 48 ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 59 Privremeni boravak iz humanitarnih razloga</p> <p>1. Privremeni boravak iz humanitarnih razloga neće se dati strancu predstavljen u sledećim slučajevima:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. ako je on/ona žrtva trgovine ljudima (u daljem tekstu poznat kao žrtve) i dobio pomoć i program za zaštitu;</p>
--	---	---



<p>vullnetar i të huajit merret parasysh kur vendoset për kohëzgjatjen e masës së ndalimit të hyrjes, përjashtuar rastet kur për interesa të rendit dhe sigurisë publike ky deklaram nuk mund të merret në konsideratë.</p> <p>2. Gjate zbatimit vullnetar të urdhër largimit i jepet përparësi kthimit si me poshtë:</p> <p>2.1. i huaji i gjetur duke qëndruar në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës por që nuk ka sjellë pasoja të dëmshme për rendin dhe sigurinë publike dhe që deklaron se do të largohet vullnetarisht nga territori i Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2. të miturit e pashoqëruar;</p> <p>2.3. personat e sëmurë, invalid ose me aftësi të kufizuara;</p> <p>2.4. prindërit me fëmijë të vegjël;</p> <p>2.5. viktimat e trafikimit me njerëz, që duan të kthehen në vendin e tyre të origjinës;</p> <p>2.6. azilkërkuesit, të cilëve iu është</p>	<p>Statement for voluntary return of the foreigner shall be considered when deciding for extension of the period of prohibitive measure for entry to, exceptionally for the cases of public order and security such a statement may not be taken into consideration.</p> <p>2. During the implementation of return decision priority to voluntary return shall be given as follows:</p> <p>2.1. a foreigner found to be illegally residing in the territory of Kosovo however who did not bring any harmful consequences for public order and security and who declares that will voluntarily leave the territory of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2. unaccompanied minors;</p> <p>2.3. sick, handicapped or persons with disabilities;</p> <p>2.4. parents with minor children;</p> <p>2.5. victims of trafficking in human beings, who want to return to their country of origin;</p> <p>2.6. asylum seekers who have been</p>	<p>Deklaracija o dobrovoljnog povratka stranaca treba da bude pregledana prilikom odlučivanja da se produži rok mera zabrana za zaulazak, osim onih slučajeva koji se odnose na javni red i sigurnost, onda ovakve izjave neće se razmatrati .</p> <p>2. Tokom dobrovoljne primene naredbe za udaljenje daje se prednost na sledeći način:</p> <p>2.1. Stranac koji je uhvacen da ilegalno boravi na teritoriju Republika Kosovo, međutim, nije izazvalo javni red i bezbednosne implikacije i izjavio da će dobrovoljno napustiti teritoriju Republike Kosovo;</p> <p>2.2. Maloletnici bez pratnje;</p> <p>2.3. bolesni, osobe sa invaliditetom ili lica sa invaliditetom;</p> <p>2.4. roditelji sa maloletnom decom;</p> <p>2.5. žrtve trgovine ljudima, koji žele da se vrate u zemlju porekla;</p> <p>2.6. tražilaca azila kojima je odbijen</p>
---	---	--



<p>refuzuar kërkesa për azil ose që kanë tërhequr kërkesën për azil dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për kthim;</p> <p>2.7. të huajin e pajisur me dokumente të rregullta udhëtimi, por që nuk ka mjete financiare të nevojshme për qëndrim;</p> <p>2.8. i huaji i cili është gjetur duke punuar në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 97 Largimi me forcë nga Republika e Kosovës</p> <p>1. Largimi me forcë i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës bëhet nga Policia Kufitare atëherë kur i huaji:</p> <p>1.1. ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës dhe ekziston dyshimi i bazuar se do të përdorë territorin e saj për të kaluar ilegalisht drejt vendeve të tjera;</p> <p>1.2. nuk është larguar nga Republika e Kosovës brenda afateve kohore, të përcaktuara në urdhrin e largimit pa ndonjë arsye objektive, apo pas largimit</p>	<p>refused asylum or who have withdrawn their application for asylum and do not have sufficient income to return;</p> <p>2.7. foreigners supplied with regular travel documents, but who do not have the financial means necessary to residence;</p> <p>2.8. foreigners who have been found working illegally in the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 97 Forced removal from the Republic of Kosovo</p> <p>1. Forced removal of a foreigner from the territory of the Republic of Kosovo shall be decided and carried out by Border Police in cases when a foreigner:</p> <p>1.1. has entered illegally in the territory of the Republic of Kosovo and there is a reasonable doubt that will use its territory to cross illegally towards other countries;</p> <p>1.2. did not leave the Republic of Kosovo within the time-limits, specified in the return decision , without any objective justification, or after leaving the territory</p>	<p>zahtev za azil ili koji su povukli zahtev za azil, a nemaju dovoljno novca da se vrate;</p> <p>2.7. Stranci opremljen sa urednim putnim ispravama, ali koji nemaju finansijskih sredstava potrebnih za boravak;</p> <p>2.8. stranci koji su uhvaćeni da rade ilegalno na teritoriji Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 97 Prinudno udaljavanje iz Republike Kosova</p> <p>1. Prinudno udaljavanje stranca sa teritorije Republike Kosovo će biti odlučeno i obavlja granična policija, u slučajevima kada je stranac:</p> <p>1.1. je ilegalno ušao u Republici Kosovo, a kada postoji osnovana sumnja da koristi ovu oblast da bi se prebacio u druge države;</p> <p>1.2. nije napustio Republiku Kosovo u navedenim rokovima u odluci da se vrate, bez ikakvog razumnog opravdanja, ili nakon izdavanja</p>
---	---	--



<p>nga territori dhe brenda afateve të ndalimit të hyrjes, ri-hyn në territorin e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. nuk e ka lëshuar territorin e Republikës së Kosovës deri në 60 ditë pas përfundimit të afatit të vizës, të lejes së qëndrimit, ose afatit të qëndrimit të parashikuar në këtë ligj për të huajt që hyjnë pa vizë;</p> <p>1.4. është ripranuar nga një vend tjetër në kuadër të Marrëveshjeve të Ripranimit në fuqi në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. është dënuar për një vepër penale për të cilën legjislacioni i Republikës së Kosovës parashikon një dënim minimal 3 vjet heqje lirie.</p> <p>2. Në rast se i huaji bëhet subjekt i largimit me forcë sipas këtij neni, ai mbahet i ndaluar në Qendër të Mbajtjes, derisa të ekzekutohet urdhri i largimit me forcë. Në rast të gjetjes së mundësive të tjera alternative, të zbatimit të masave të përkohshme siç përcaktohen me këtë ligj, këto të fundit kanë prioritet ndaj ndalimit.</p>	<p>and within the period of the entry ban, re-enters the territory of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. did not leave the territory of the Republic of Kosovo up to 60 days after the expiry of the visa, residence permit or time-limit laid down in this law, for the foreigners entering without a visa;</p> <p>1.4. has been readmitted by another country within the framework of readmission agreements in force in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. is convicted of a criminal offense for which the legislation of the Republic of Kosovo provides a minimum sentence of 1 years imprisonment.</p> <p>2. In the event the foreigner is subject to removal by force according to this article, he/she shall be kept in a detention center, till the execution of the removal order by force. In case of finding other alternative possibilities, for the implementation of temporary measures as defined by the law, the latter ones have priority over detention.</p>	<p>teritorije i unutar zabrane ulaska, oni su ponovo usli na teritoriju Republike Kosovo;</p> <p>1.3. nije napustio teritoriju Republike Kosovo do 60 dana nakon isteka vize, boravišne dozvole ili rokovima propisanim ovim zakonom, za strance koji ulaze bez vize;</p> <p>1.4. prihvacen je od druge države, u okviru sporazuma o readmisiji koji su na snazi u Republici Kosovo;</p> <p>1.5. je osuđen za krivično delo, za koje zakoni Republike Kosovo obezbeđuje minimalnu kaznu od godinu dana zatvora.</p> <p>2. U slučaju da je stranac deo prinudnog udaljavanja, u skladu sa ovim članom, ona će biti održan u pritvornom centru do izvršenog naloga za prinudno udaljavanje. U slučaju da postoje alternativne opcije za uvođenje privremenih mera koje su definisane zakonom, ove zadnje imaju prednost nad kaznom.</p>
---	--	---



<p>3. I huaji, i cili nuk disponon një dokument udhëtimi duhet të paraqitet vetë ose i shoqëruar nga autoritetet kompetente, pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore të akredituara në Republikën e Kosovës, për t'u pajisur me një dokument të tillë.</p>	<p>3. A foreigner who does not possess a travel document must appear in person or accompanied by the competent authorities, at the diplomatic and consular missions accredited in the Republic of Kosovo, in order to obtain such a document.</p>	<p>3. Stranac koji nema putnu ispravu mora da se lično prijavi ili u pratnji nadležnih organa, diplomatske misije ili konzularnog koje su priznala Republiku Kosovo, u cilju dobijanja takvih dokumenata.</p>
<p>4. Nëse në Republikën e Kosovës nuk ka përfaqësi diplomatike dhe konsullore të vendit të shtetasit të huaj, autoriteti përgjegjës në kuadër të MPB-së kërkon pajisjen me dokument udhëtimi në vendin e origjinës ose në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të vendit të shtetasit të huaj në ndonjë vend tjetër, nëpërmjet Drejtorisë Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme.</p>	<p>4. If in the Republic of Kosovo there is no diplomatic and consular missions of the country of the foreign national, the responsible authority within the Ministry of Internal Affairs, shall make a request for obtaining a travel document in the country of origin or in the country's diplomatic and consular representations of the foreign national at another place, through the Consular Department of the Ministry of Foreign Affairs.</p>	<p>4. Ako Republika Kosovo nema diplomatske i konzularne misije u zemlji za strane državljane, nadležni organ u okviru Ministarstva Unutrašnjih Poslova, će podneti zahtev za dokumenta da putuju u zemlju porekla ili diplomatskog ili Konzularna predstavništva stranih državljana u nekoj drugoj zemlji, preko konzularnog odeljenja Ministarstva Spoljnih Poslova.</p>
<p>5. Në rast se përfaqësia diplomatike nuk mund të lëshojë dokument udhëtimi, MPB –ja e pajisë të huajin me dokument standard udhëtimi të përcaktuar me marrëveshje ripranimi, i cili ka për qëllim zbatimin e largimit me forcë të të huajit.</p>	<p>5. In case that the diplomatic representation cannot issue a travel document, MIA shall provide the foreigner with a standard travel document as defined under the readmission agreement, whose intentions are to implement the forced removal of the foreigner.</p>	<p>5. U slučaju da je diplomatsko predstavništvo odbije da izda putnu ispravu, MUP mora obezbediti stranca sa putnom ispravom, kao što je određeno od strane sporazuma o readmisiji, čiji je cilj implementacija prinudnog udaljavanja.</p>
<p>6. Në zbatim të këtij ligji, MPB-ja mund t'i lëshoj fletudhëtim të huajit, nëse i huaji nuk pajiset me dokument udhëtimi, sipas nenit 7</p>	<p>6. In the course of enforcement of this law, MIA may issue a travel sheet to a foreigner, if the foreigner is not supplied with a travel</p>	<p>6. U toku sprovođenja ovog zakona, MUP strancu može izdati papir putovanja, ukoliko stranac nije</p>



<p>të këtij ligji.</p> <p>7. MPB në bazë të marrëveshjeve në fuqi në Republikën së Kosovës mund të bashkëpunoj me vende të tjera në procedurën e kthimit, apo kthimeve të përbashkëta të të huajve.</p> <p>8. Të huajit i komunikohet në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, se ndaj tij do të ekzekutohet masa administrative e largimit me forcë, duke i shpjeguar arsyet e nxjerrjes së urdhrit, datën dhe vendin ku do të ekzekutohet, mënyrën e transportimit të tij për në vendin e destinacionit dhe afatin e ndalimit të hyrjes. Forma dhe procedura e urdhër largimit me forcë përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga MPB-ja.</p> <p style="text-align: center;">Neni 98 Ankesa ndaj urdhrit të largimit me force</p> <p>1. I huaji ka të drejtë ankese brenda 8 ditëve, pas pranimit të urdhër largimit me forcë te Komisioni i Ankesave. Komisioni duhet ta zgjidh çështjen brenda afatit prej 15</p>	<p>document, in accordance with Article 7 of this law.</p> <p>7. MIA on the basis of agreements in force in the Republic of Kosovo may cooperate with other countries in the return procedure, or joint returns of foreigners.</p> <p>8. To a foreigner shall be communicated in writing, in one of the official languages and in English that against him/her the administrative measures of forced removal shall be executed, explaining the reasons for the issuance of the removal order, the date and place where it will be executed, mode of his transportation to the place of destination and the length of entry ban. The form of forced removal order shall be determined by a by-law issued by the MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 98 Appeal against a forced removal order</p> <p>1. The foreigner has the right to appeal within 8 days after receipt of removal order by force at the Appeals Commission. Commission should resolve the issue within</p>	<p>opremljen sa putnim ispravama, u skladu sa članom 7 ovog zakona.</p> <p>7. MUP u skladu sa sporazumima koji su na snazi u Republici Kosovo, može da sarađuje sa drugim državama u postupku oporavka, ili zajednički povratak stranaca.</p> <p>8. Stranac će biti obavješten u pisanoj formi, na jednom od službenih jezika i na engleski protiv njegove / njene volje da se izvrše administrativne mere za prinudno udaljavanje, i on je objasnio razloge za izdavanje naloga za udaljavanje, datum i mesto gde ce se izvrši nalog za udaljavanje, način prevoza do mesta kao i trajanje zabrane za ulazak. Sredstvo za prinudno udaljavanje će se utvrditi sa podzakonskim aktom, izdat od strane MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 98 Žalba protiv naredbe za prinudno udaljenje</p> <p>1. Stranac ima pravo na žalbu Komisiji za žalbe, u roku od 8 dana od dana prijema naredbe za prinudno udaljavanje. Ta komisija bi trebalo da</p>
---	---	--



<p>ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa kundër vendimit lidhur me urdhrin e largimit me forcë, nuk e pezullon ekzekutimin e urdhër largimit me forcë.</p> <p>2. Në rastet kur i huaji është i pakënaqur me vendimin e komisionit atëherë ai mundet të hap konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore, brenda 8 ditëve nga marrja e vendimit. Gjykata duhet të zgjidh çështjen nga ky paragraf brenda afatit prej 60 ditëve nga dita e pranimit të padisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 99 Procedurat e zbatimit të urdhrit të dëbimit</p> <p>1. Urdhri i dëbimit zbatohet nga Policia Kufitare, e cila:</p> <p>1.1. merr masa për ndalimin e të huajit në Qendrën e Mbajtjes, ose zbatimin e masave të përkohshme të përcaktuara në këtë ligj, derisa të zbatohet urdhër dëbimi;</p> <p>1.2. merr shenjat e gishtërinjve dhe të pëllëmbës së dorës të të huajit, fotografinë dhe shenjat biometrike;</p>	<p>15 days of the receipt of an appeal. The appeal against the decision on the removal by force, does not suspend the execution of the warrant removal by force</p> <p>2. In cases where the foreigner is dissatisfied with the decision of the Commission then may lodge an administrative dispute to the Basic Court within 8 days of the receipt of the decision. The court should resolve the issue referred to in this paragraph within 60 days of the receipt of the appeal.</p> <p style="text-align: center;">Article 99 Enforcement procedures of a removal order</p> <p>1. Enforcement of the removal order shall be carried out by the Border Police which:</p> <p>1.1. undertakes measures to keep the foreigner in a detention center, or for the application of temporary measures specified in this law, until the removal order is enforced;</p> <p>1.2. takes fingerprints and palm of the hand of the foreigner, photograph and biometric data;</p>	<p>reši problem u roku od 15 dana od dana prijema žalbe. Zalba ne resenje o uklanjanju silom, ne obustavlja izvršenje naredbe uklanjanja silom.</p> <p>2. U slučajevima gde stranac nije zadovoljan odlukom Komisije, on/ona može pokrenuti upravni spor u Centralnom Sudu, u roku od 8 dana od dana prijema odluke. Sud bi trebalo da reši pitanje iz ovog stava, u roku od 60 dana od dana prijema žalbe.</p> <p style="text-align: center;">Član 99 Procedure za sprovođenje naredbe za udaljenje</p> <p>1. Nalog za proterivanje primeni se od strane Granične Policije, koja:</p> <p>1.1. ce preduzeti mere kako bi se stranca zadržali u pritvorskom centru, ili primena privremenih mera navedenih u ovom zakonu je na snazi sve dok je na snazi nalog za prinudno udaljavanje;</p> <p>1.2. uzeti otiske prstiju i dlanova od ruku stranca, i uzima bimoetrijske podatke i fotografiju;</p>
---	---	--



<p>1.3. regjistron urdhrin për dëbim në bazat përkatëse të të dhënave, ku shënohet periodha e ndalimit të hyrjes në Republikën e Kosovës dhe pikën e kalimit kufitar të largimit të të huajit;</p> <p>1.4. inicion pranë institucioneve përgjegjëse marrjen e masave të parapara për pajisje me fletudhëtim, sigurimin e kthimit në vendin e origjinës dhe biletën e udhëtimit.</p> <p>2. Urdhri i dëbimit zbatohet menjëherë, në rast se prania e të huajit përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë shtetërore.</p> <p>3. Në rast se as i huaji e as ftuesi nuk kanë mundësi financiare për të përballuar shpenzimet e kthimit të të huajit në vendin e destinacionit, shpenzimet e udhëtimit do të jepen si hua në paradhënie nga MPB-ja dhe do të kthehen nga ftuesi në rast se i huaji kërkon të vij në Republikën e Kosovës pas përfundimit të afatit të ndalimit të hyrjes ose nga punëdhënësi i tij i ardhshëm.</p>	<p>1.3. registers the removal order in relevant data bases, stating the period of prohibition of entry into the Republic of Kosovo and the border crossing point of departure of the foreigner;</p> <p>1.4. initiates undertaking of measures for the supply with the travel paper and ensures the return to the country of origin and a travel ticket.</p> <p>2. The removal order shall be enforced immediately, in case the presence of the foreigner constitutes a threat to public order and state security.</p> <p>3. In the event that neither the foreigner nor the host have the financial capabilities to afford the return expenses of a foreigner in the country of destination, travel expenses will be given as an advance loan from MIA and will be paid back by the host if the foreigner desires to come to the Republic of Kosovo after the expiration of the entry ban, or from his future employer.</p>	<p>1.3. upisuje naredbe za udaljavanje u relevantnim bazama podataka, navodeći dužinu zabrane za ulazak Republike Kosova i graničnog prelaza na kome stranac se udaljava;</p> <p>1.4. inicira mere za opremanje stranca sa papirima putovanja, avionsku kartu i osigura njegov povratak u zemlju porekla</p> <p>2. Redosled udaljavanja stupa na snagu odmah, u slučaju da stranac predstavlja opasnost za javni poredak i nacionalnu bezbednost.</p> <p>3. U slučajevima gde ni domaćin ni stranac nemaju finansijske mogućnosti da ispuni troškove povratka stranca u zemlji destinacije, putni troškovi će biti na raspolaganju kao kredit unapred od strane MUP-a, anovac će vratiti domaćin, ako stranac želi da se vrati u Republici Kosovo, nakon isteka zabrane ulaska, odnosno od strane budućeg poslodavca.</p>
--	---	---



Neni 100 Kategoria e të huajve që nuk dëbohen	Article 100 Categories of foreigners that shall no be removed	Član 100 Kategorija stranaca koji neće biti udaljeni
<p>1. I huaji nuk dëbohet nëse i plotëson njëri nga kushtet e mëposhtme:</p> <p>1.1 është i pajisur me leje qëndrim të përhershëm;</p> <p>1.2 ka lindur në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.3 ka hyrë në Republikën e Kosovës si i mitur i pashoqëruar dhe është pajisur me leje qëndrim të përhershëm;</p> <p>1.4 është i pajisur me leje të përkohshme qëndrimi dhe është martuar me një të huaj, i cili ka leje të përhershme qëndrimi ose me një shtetas të Kosovës;</p> <p>1.5 ekziston dyshimi i bazuar se i huaji, në vendin e origjinës apo në një vend tjetër, do të dënohet me vdekje, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimeve për shkaqe diskriminuese;</p> <p>1.6 i mituri i pashoqëruar, nëse nga</p>	<p>1. A foreigner shall not be forcibly removed if one of the following conditions are met:</p> <p>1.1. is in possession of permanent residence permit;</p> <p>1.2. is born in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. has entered into the Republic of Kosovo as an unaccompanied minor and has been fitted with a permanent residence permit;</p> <p>1.4. has been fitted with a temporary residence permit and is married to a foreigner who has a permanent residence permit or is a citizen of Kosovo;</p> <p>1.5. there is a reasonable doubt that the foreigner, in his/her country of origin or another country, shall be punished by death, shall be subject to torture, inhuman or degrading treatment or punishment for discriminatory reasons;</p> <p>1.6. an unaccompanied minor, if the</p>	<p>1. Stranac ne sme biti prinudno udaljen, ako ispunjava jedan od sledećih prijavljenih uslova:</p> <p>1.1. poseduju trajnu boravišnu dozvolu;</p> <p>1.2. je rođen u Republici Kosovo;</p> <p>1.3. je ušao u Republiku Kosovo kao maloletnik bez pratnje, a opremljen je sa dozvolom stalnog boravka;</p> <p>1.4. je opremljen sa dozvolom privremenog boravka i je braku sa strancem koji ima stalni boravak ili koji je državljanin Republike Kosova;</p> <p>1.5. postoji osnovana sumnja da je stranac u njegovu / njenu zemlju porekla ili u drugoj državi, ce biti kaznjen smrću, biće mučeni, imace nečovečno ili ponižavajuće postupanje ili će biti kažnjen zbog diskriminacije;</p> <p>1.6. je bez pratnje, ako zemlja</p>



<p>vendi i origjinës, një vend tjetër ose nga institucione të tjera nuk garantohet ribashkimi familjar ose kujdesi i duhur shëndetësor;</p> <p>1.7 është anëtar i familjes së të huajit, të cilit i njihet statusi i refugjatit në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Përjashtimisht, i huaji mund të dëbohet, edhe pse përmbushen kushtet e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, në qoftë se qëndrimi i tij rrezikon rendin dhe sigurinë publike, si dhe përbën kërcënim për sigurinë shtetërore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 101 Ankesa ndaj urdhër dëbimit</p> <p>1. Ndaj urdhër dëbimit i huaji ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Themelore, brenda 8 ditëve nga data e marrjes së vendimi.</p> <p>2. Vendimi i Gjykatës Themelore mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit brenda 8 ditëve, e cila e shqyrton çështjen me përparësi.</p>	<p>country of origin or another country or other institutions guarantee not family reunification or adequate health care;</p> <p>1.7. is a family member of a foreigner whose refugee status is recognized in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Exceptionally, a foreigner may be removed, even though he meets the conditions referred to in paragraph 1. of this Article, if his/her residence threatens public order and security, and constitutes a threat to national security.</p> <p style="text-align: center;">Article 101 Appeal against a removal order</p> <p>1. Against a removal order a foreigner have the right to appeal at a Basic Court, within 8 days of the receipt of the decision.</p> <p>2. Basic Court decision may be appealed at Court of Appeals within 8 days which shall review the case with a priority.</p>	<p>porekla ili drugoj državi ili drugim institucijama da obezbede da nema nikakvo porodično okupljanje ili adekvatnu zdravstvenu zaštitu;</p> <p>1.7. član porodice stranca čiji je izbeglički status priznat u Republici Kosovo.</p> <p>2. Izuzetno, stranac može biti udaljen iako ispunjava uslove iz stava 1. ovog člana, ako boravak ugrožava javni red i bezbednost, kao i da predstavlja pretnju za nacionalnu bezbednost.</p> <p style="text-align: center;">Član 101 Žalba protiv naredbe o prinudnom udaljivanju</p> <p>1. Protiv naredbe o prinudnom udaljavanju, stranac ima pravo da uloži žalbu u Centralnom Sudu, u roku od 8 dana od dana prijema odluke.</p> <p>2. Za odluku Osnovnog Suda može se uložiti žalba Apelacionom Sudu, u roku od 8 dana, koja bi trebala da razmatra slučaj sa prioriteto.</p>
--	---	---



Neni 102 Ekzekutimi i masave të përkohshme	Article 102 Execution of temporary measures	Član 102 Sprovođenje privremenih mera
<p>1. Masat e përkohshme ndërmerren nga Policia Kufitare për të përgatitur apo siguruar zbatimin e një urdhri për largimin e të huajit nga territori ose për të mbikëqyrë largimin e tij.</p> <p>2. Masat e përkohshme ndërmerren si masa alternative të ndalimit në Qendër të Mbajtjes së të Huajve që janë subjekt i largimit me forcë, bazuar në shqyrtimin rast pas rasti, pa ndikuar në garantimin e ekzekutimit të urdhrit të largimit me forcë.</p> <p>3. Masat e përkohshme mund të merren menjëherë pas nxjerrjes së urdhër largimit me forcë, por mund të zëvendësojnë nëse është e nevojshme, masën e ndalimit në Qendër të Mbajtjes pasi ajo është nxjerrë dhe është zbatuar.</p> <p>4. Kriteret, procedurat dhe forma e urdhër dëbimit do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga MPB.</p>	<p>1. Temporary measures shall be undertaken by the Border Police to prepare and ensure the implementation of a removal order of a foreigner from the territory or to supervise his/her removal.</p> <p>2. Temporary measures shall be taken as alternative detaining measures in the detention center for foreigners who are subject to removal by force, based on a case-by-case review, without affecting in guaranteeing the execution of the removal order by force.</p> <p>3. Temporary measures can be taken immediately after the issuance of the removal order by force, but can be replaced, if necessary, the detaining measure at the center after it is issued and enforced.</p> <p>4. Criteria, procedures and forms of the removal order shall determine by an MIA sublegal enactments.</p>	<p>1. Privremene mere će biti preduzete od strane granične policije da pripremi i obezbedi sprovođenje naloga za proterivanje stranaca sa teritorije ili da nadgleda njihovo udaljavanje.</p> <p>2. Privremene mere će biti preduzete kao alternativne mere za pritvor za strance koji su deo prinudnog udaljavanja, na osnovu razmatranja slučaja do slučaja, bez ikakvog uticaja u garantovanju izvršenje naredbe o prinudnom udaljavanju.</p> <p>3. Privremene mere se mogu preduzeti odmah nakon donošenja naredbe o prinudnom udaljavanu, ali ako je potrebno može se zameniti u kaznena mere u centru nakon sto je izdata i da stupila na snagu.</p> <p>4. Kriterijume, procedure i oblici prinudnog udaljavanja će se utvrditi administrativnim nalogom izdat od strane MUP-a.</p>



Neni 103 Detyrimi për tu paraqitur pranë autoriteteve publike	Article 103 Obligation to appear to authorities	Član 103 Obaveza za prijavljivanje u javnim organima
<p>1. I huaji mund të detyrohet të paraqitet në periudha të rregullta kohore pranë Policisë Kufitare kur:</p> <p>1.1. ndaj tij është nxjerrë një urdhër largimi nga territori dhe kërkohet siguri për zbatimin e këtij urdhri apo nevojitet të mbikëqyret largimi i të huajit nga territori;</p> <p>1.2. i huaji para largimit ka pasur një adresë të saktë dhe të njohur nga Policia Kufitare dhe nuk ka të dhëna se i huaji mund t'i shmanget zbatimit të largimit dhe nuk i ka respektuar afatet e largimit vullnetar;</p> <p>1.3. vlerësohet interesi më i mirë i familjes së të huajit.</p> <p>2. I huaji i cili detyrohet të paraqitet pranë Policisë Kufitare, duhet të informohet për arsyet e këtij detyrimi.</p> <p>3. Detyrimi për tu paraqitur mbetet në fuqi deri kur i huaji i përmbush kërkesat për</p>	<p>1. A foreigner may be obliged to report on regular period of times at the Border Police when:</p> <p>1.1. against him a removal order from the territory has been issued and security is required for the implementation of this order or it is required supervision of foreigner's removal from the territory;</p> <p>1.2. the foreigner before removal had a correct and a known address by the Border Police and there are no indications that the foreigner may avoid the implementation of the removal and haven't respected the terms for voluntary removal;</p> <p>1.3. assess the best interest of the family of the foreigner.</p> <p>2. The foreigner who has to report to the Border Police should be informed about the reasons of such an obligation.</p> <p>3. Obligation to report in shall remain in force until the foreigner meets the</p>	<p>1. Stranac može biti dužan da se javi u redovnim vremenskim periodima granične policije, kada je:</p> <p>1.1. je protiv njega je izdato naredba za udaljivanje iz teritorija, i za sprovođenje ovog naloga se zahteva bezbednost ili nadzor udaljavanja stranaca sa teritorije;</p> <p>1.2. Pre udaljavanja stranac je imao tačnu adresu i poznatu za graničnu policiju, i nema naznaka da stranac može da izbegne sprovođenju udaljavanja i da nije u postovao uslovime za dobrovoljno udaljavanje;</p> <p>1.3. procenjuju se najbolji interesi porodice stranca.</p> <p>2. stranac koji treba da se prijavi u graničnoj policiji treba da bude obavešten o razlozima takve obaveze.</p> <p>3. Obaveza da se prijavi ostaje na snazi sve dok stranac ispunjava uslove za</p>



<p>largimin nga territori, apo kur shqyrtimi i çështjes ka përfunduar ndryshe. Detyrimi për tu paraqitur do të marrë fund menjëherë kur nuk është më e nevojshme për të kërkuar zbatimin e një mase të tillë.</p>	<p>requirements for removal from the territory, or when examination of the case has concluded otherwise. Obligation to report in shall cease immediately when no longer is deemed necessary to seek the implementation of such a measure.</p>	<p>udaljavanje sa teritorije gde razmatranje predmeta donese drugi zakljucak. Obaveza da se prijavi odmah prestaje da postoji kada vise nije potrebno da se sprovede jedna takva mera.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 104 Sekuestrimi i biletës ose i dokumentit të udhëtimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 104 Temporary confiscation of the ticket or travel document</p>	<p style="text-align: center;">Član 104 Privremena konfiskacija karte ili putne isprave</p>
<p>1. Në rast se i huaji është subjekt i një urdhri largimi me forcë ose dëbimi, Policia Kufitare mund të sekuestrojë biletën e udhëtimit dhe të dokumentit të udhëtimit, për garantimin e kthimit. Procedurat e sekuestrimit do të përcaktohen me akt nënligjor nga MPB-ja.</p> <p>2. Policia Kufitare sekuestron dokumentet e udhëtimit të të huajit deri kur vendimi, nga një procedurë administrative, merr formë të prerë ose deri kur të paguhet gjoba, apo deri në përfundimin e afatit të vendosur nga gjykata apo nga prokuroria.</p> <p>3. Gjatë kohës së sekuestrimit të dokumenteve të udhëtimit, të huajit i lëshohet një vërtetim.</p>	<p>1. In case a foreigner is subject to a forced removal or removal order, the Border Police may, to ensure the return, confiscate the ticket and travel document. Procedures of confiscation shall be adopted with a bylaw by the Minister of Internal Affairs.</p> <p>2. The Border Police shall confiscate foreigner's travel document until the decision of an administrative procedure becomes final or the fine is paid, or end of the deadline set by a court or the prosecution.</p> <p>3. For the time the travel document is held confiscated, to the foreigner is issued a certificate.</p>	<p>1. U slučaju da je stranac je deo naloga za prinudno udaljavanje, pogranična policija, iz bezbednosnih razloga povratka mogu konfidkovati ili oduzeti kartu ili putnu ispravu. Procedure za oduzimanje će biti uspostavljena sa aktom od strane MUP-a.</p> <p>2. Granična policija će oduzeti putnu ispravu stranca, do konačne odluke ili upravni postupak sve dok se kazna ne plaća, ili prestaje vremenski rok koji utvrđen sudksom odlukom ili krivicno gonjenje.</p> <p>3. Za vreme za koje se drže oduzete putne isprave, strancu se izdaje potvrda.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 105 Sekuestrimi i mjeteve financiare ose vendosja e garancisë</p> <p>1. Policia Kufitare i sekuestron të huajit mjetet financiare nëse posedon, deri në shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e kthimit të tij. Pjesa e mbetur nga garancia financiare i kthehet të huajit menjëherë.</p> <p>2. Në vend të masave të tjera të përkohshme, ose paralelisht, sipas vlerësimit rast pas rasti, Policia Kufitare mund t'i kërkoj të huajit të vendos një garancion financiar me anë të cilit garanton kthimin e tij.</p> <p>3. Garancia financiare i kthehet të huajit menjëherë kur kjo vlerësohet se nuk është më e nevojshme ose kur realizohet kthimi i të huajit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 105 Confiscation of financial means or imposing a guarantee</p> <p>1. The Border Police shall confiscate to a foreigner the financial means if he/she owns up to the amount necessary to cover the costs of his/her return. The remainder of the financial guarantee shall be returned to the foreigner right away.</p> <p>2. Instead of other temporary measures, or in parallel, according to the case-by-case assessment, Border Police may require from the foreigner to deposit a financial guarantee by which he/she guarantees his/her return.</p> <p>3. Financial guarantee shall be returned to the foreigner immediately when it is estimated that there is no longer necessary or when the return of the foreigner is carried out.</p>	<p style="text-align: center;">Član 105 Oduzimanje finansijskih sredstava ili postavljanje garancije</p> <p>1. Granična Policija će oduzeti finansijska sredstva stranca ako poseduje finansijsku iznos potreban za pokrivanje troškova za njegov povratak. Ostatak finansijske garancije će se odmah vratiti u strancu.</p> <p>2. Umesto toga, druge privremene mere, ili paralelno, prema proceni slučaja - do - slučaja, Granična policija može da zatraži od stranca da položi finansijske garancije, kroz koje je on garantuje za njegov povratak.</p> <p>3. Finansijska garancija će biti vraćena odmah strancu nakon procene da nije vise potrebno ili kada se izvrsi udaljavanje stranca.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 106 Qëndrimi i detyrueshëm në një territor të caktuar</p> <p>1. Policia Kufitare vendos kufizimin e lirisë së lëvizjes të të huajve, duke e urdhëruar atë të qëndrojë në një territor të caktuar, në</p>	<p style="text-align: center;">Article 106 Restrictions on freedom of movement</p> <p>1. Border Police imposes restrictions to freedom of movement of foreigners, ordering him/her to residence in a given territory, if:</p>	<p style="text-align: center;">Član 106 Obavezni boravak u određenom području</p> <p>1. Granična policija upostavlja ograničenja slobode kretanja za stranca, naredivsi im da ostanu na određenom</p>



<p>rastin kur:</p> <p>1.1. rikthimi, ose dëbimi nuk mund të urdhërohet apo zbatohet, për arsye objektive ose për shkak të një detyrimi të marrë përsipër nga Republika e Kosovës në kuadër të një marrëveshjeje ndërkombëtare në fuqi;</p> <p>1.2. ka një leje qëndrimi për arsye humanitare;</p> <p>1.3. ka përfunduar afati i ndalimit në Qendër të Mbajtjes dhe nuk është i mundur largimi i të huajit ose për arsye humanitare i huaji nuk mund të mbahet i ndaluar në Qendër të Mbajtjes;</p> <p>1.4. në rastet kur autoritetet e shëndetit publik, në bazë të një vlerësimi dhe sipas Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, rekomandojnë izolimin e personit apo personave për një periudhë kohore të vlefshme për izolimin e sëmundjes së dyshuar.</p> <p>2. I huaji ka të drejtë të parashtroj padi në Gjykatën Themelore kundër urdhrit për qëndrim në një territor të caktuar, njëjtë si ndaj urdhrit të ndalimit të të huajit në Qendrën e Mbajtjes.</p>	<p>1.1. the return or removal can not be ordered or implemented, for objective reasons or because of an obligation taken over by the Republic of Kosovo in the framework of an international agreement in force;</p> <p>1.2. has a residence permit for humanitarian reasons;</p> <p>1.3. the period of detention have been concluded at the detention center and removal of a foreigner is not possible or for humanitarian reasons the foreigner can not be kept detained at the detention center;</p> <p>1.4. in cases when public health authorities, based to an assessment and in accordance with the International Health Regulation, recommend the isolation of the person or persons for a period of time valid for the isolation of the suspected disease.</p> <p>2. The foreigner has the right to lodge an appeal at a Basic Court against the residence order in a given territory, same as against the detention order to the foreigner at the detention center.</p>	<p>području, ako:</p> <p>1.1. ponovni povratak ili odlaganje ne može odrediti ili sprovesti, zbog objektivnih razloga ili zbog obaveze preuzete od strane Republike Kosovo, u okviru međunarodna sporazuma koji je na snazi;</p> <p>1.2. dozvola boravka iz humanitarnih razloga;</p> <p>1.3. kazneni period je završen u centru za pritvor i udaljavanje stranca nije dostupno ili iz humanitarnih razloga, stranac ne može biti održan u centru za pritvor;</p> <p>1.4. u slučajevima kada javni zdravstveni organi, na osnovu procene, a u skladu sa međunarodnim zdravstvenim propisima, preporučuju izolaciju lica ili više lica za period koji se odnosi na izolaciju zbog sumnje na bolest.</p> <p>2. Stranac ima pravo da uložiti žalbu na Centralnom Sudu protiv naredbe da ostane na određenoj teritoriji, isto kao i za određivanje pritvora protiv stranca u pritvorskom centru.</p>
---	--	--



<p>3. Policia Kufitare në urdhrin për qëndrim në një territor të caktuar, përcakton rregullat e përgjithshme të qëndrimit, vendin dhe kohëzgjatjen e qëndrimit, si dhe njofton të huajin të paraqitet pranë autoriteteve kompetente policore për çdo muaj. Forma e urdhrin të qëndrimit të detyrueshëm në një territor të caktuar përcaktohet me akt nënligjor nga MPB-ja.</p> <p style="text-align: center;">Neni 107 Qendra e Mbajtjes</p> <p>1. Qendra e Mbajtjes duhet të ketë nivel të caktuar të sigurisë dhe kufizim të lirisë, në të cilin mund të mbahen vetëm të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë apo dëbimi nga territori i Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Qendra e Mbajtjes duhet të plotësojë të gjitha kushtet e një trajtimi njerëzor si dhe respektimin e të drejtave njerëzore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe të mundësojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore.</p> <p>3. DSHAM-i në rast të ndalimit të një të huaji në Qendër të Mbajtjes me kërkesën e këtij të fundit, merr masa të menjëhershme për kujdesin ndaj anëtarëve të familjes së të</p>	<p>3. Border Police shall specify in the order the residence in a given territory, define the general rules of residence, place and length of the residence, as well as notify the foreigner to report in at the competent police authorities every month. Form of the forced residence order in a given territory shall be defined under a by-law to be issued by MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 107 Detention Center</p> <p>1. Detention centers shall have a certain level of security and of freedom limitations, where may only be kept a foreigner who is the subject of forced removal or removal from the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Detention center must meet all conditions of human treatment as well as respect for human rights guaranteed by the Constitution of Kosovo and to enable the provision of health services.</p> <p>3. DCAM in the case of detaining a foreigner in the detention center, at the request of the latter, shall take immediate measures for taking care for the family members of the</p>	<p>3. Granična policija treba da precizira da bi ostali u određenom području, i definišu opšta pravila boravka, mesto i dužine boravka, kao i da obavesti stranca koji se pojavljuje na nadležnim organima policije svakog meseca. Forma naloga za prinudni boravak na odredjenu teritoriju će biti definisan podzakonskim aktom izdatim od strane MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 107 Pritvorni Centar</p> <p>1. Pritvorski centri treba da imaju određeni nivo bezbednosti i ograničenja slobode, koja se može održati samo na strance, koji su deo prinudnog udaljavanja, ili napuštanja teritorije Republike Kosovo.</p> <p>2. Pritvorni Centar mora da ispuni sve uslove ljudskog postupanja i da se omogući pružanje zdravstvenih usluga.</p> <p>3. DDAM je, u slučaju zadržavanja stranca u pritvorskom centru, na zahtev drugog, treba da preduzme hitne mere da se brinu za članove porodice pritvorenog</p>
--	--	--



<p>huajit të ndaluar, të cilët kanë mbetur pa mbikëqyrje.</p> <p>4. Qendra e Mbajtjes është pjesë e strukturës organizative të MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 108 Ndalimi në Qendër të Mbajtjes</p> <p>1. Ndalimi në Qendrën e Mbajtjes është masë e fundit administrative, që nxjerrët dhe ekzekutohet nga Policia Kufitare, ndaj të huajit, për të cilin është nxjerrë një urdhër largimi me forcë apo dëbimi, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë zbatuar të gjitha masat e mundshme alternative apo kur nga vlerësimi konsiderohet se këto masa nuk mund të zbatohen për të huajin, ose për të huajin e i cili është në procedurë të ripranimit në bazë të marrëveshjeve të ripranimit në fuqi.</p> <p>2. I huaji qëndron i ndaluar në Qendër të Mbajtjes, në afate sa më të shkurtra kohore, derisa të kryhen procedurat ligjore, për të mundësuar largimin e tij nga Republika e Kosovës, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>3. Policia Kufitare mund të ndalojë të huajin</p>	<p>detained foreigner, who are left unattended by.</p> <p>4. Detention center is part of the organizational structure of the MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 108 Detainment at the detention center</p> <p>1. Detainment at the detention center is a last resort administrative measure, which is issued and executed by the Border Police, against a foreigner, for whom a forced removal or removal order has been issued, based on the case-by-case assessment, when all possible alternative measures are implemented or when based on an assessment such measures are considered inapplicable to a foreigner, or to a foreigner who is under readmission procedures according to readmission agreements in force.</p> <p>2. A foreigner shall remain detained in the detention center, for the shortest period of time, until the legal proceedings are carried out, to enable his removal from the Republic of Kosovo, within the period of time specified in this law.</p> <p>3. Border police may detain a foreigner in</p>	<p>stranca, koji su ostali bez nadzora.</p> <p>4. Pritvorni Centar je deo organizacione strukture MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 108 Zadržavanje u pritvornom centru</p> <p>1. zadržavnje u pritvorskom centru je poslednji upravni postupak, koji se izdaje i sprovodi se od strane granične policije, protiv stranca, za koje je nalog za prinudno udaljavanje, na osnovu procene slučaja - od slučaja. Kada se sprovede sve moguće mere ili alternative zasnovana na proceni da su takve mere smatraju nemoguće primeniti na stranca , ili stranca koji je u postupku readmisije , na osnovu sporazuma o readmisiji koja je na snazi.</p> <p>2. Stranac će ostati u pritvoru u pritvorskom centru u najkraćem mogućem roku, dok se zakonske procedure se izvode, da bi omogućio njegovo udaljavanje iz Republike Kosovo, u roku koji je naveden u ovom zakonu.</p> <p>3. Granična policija može da zadrži</p>
--	--	--



<p>në Qendër të Mbajtjes, për arsye të sigurisë publike, vërtetimit të identitetit apo arsye tjera.</p> <p>4. I huaji njoftohet në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, për ndalimin në Qendër të Mbajtjes, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën të sigurojë mbrojtjen ligjore të tij, si dhe të kontaktoj me të afërmit e vet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 109 Ankesa ndaj urdhrit të ndalimit</p> <p>1. I huaji, ka të drejtë të parashtojë padi kundër urdhrit për ndalim, në Gjykatën Themelore, brenda 30 ditëve pas pranimit të urdhrit për ndalimin ose zgjatjen e ndalimit.</p> <p>2. Padia ndaj vendimit të Gjykatës Themelore bëhet në Gjykatën e Apelit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 110 Koha e ndalimit në Qendrën e Mbajtjes</p> <p>1. I huaji ndalohet në Qendër të Mbajtjes</p>	<p>the detention center for the reasons of public security, identity verification or other reasons.</p> <p>4. A foreigner shall be notified in written form, in one of the official languages and in English, for his/her detainment at the detention center, which shall contain the reasons for the detention, the detention period, the right to provide him/her with legal protection, as well as to contact his/her relatives.</p> <p style="text-align: center;">Article 109 Appeal against a detaining order</p> <p>1. A foreigner has the right to appeal against the detaining order, to the Basic Court, within 30 days after receipt of the detaining order or extension of detainment.</p> <p>2. Appeal against the decision of the Basic Court shall be lodged at the Court of Appeals according to the relevant legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 110 Detaining period at the detention center</p> <p>1. A foreigner is detained at the detention</p>	<p>stranca u pritvornom centru iz razloga javne bezbednosti, za utvrđivanje identiteta ili iz drugih razloga.</p> <p>4. Stranac će biti obavešten u pisanoj formi, na jednom od službenih jezika i na engleskom, za njegov / njen pritvor u Pritvornom centru, koji će sadržati razloge za pritvor, trajanja pritvora, ponuđeno pravo njoj / njemu za pravnu zaštitu i pravo za kontaktiranje njegove/njene porodice.</p> <p style="text-align: center;">Član 109 Žalba protiv naloga o pritvoru</p> <p>1. Stranac ima pravo na žalbu protiv naloga o pritvoru, Centralni Sud u roku od 30 dana od dana prijema naloga za pritvor ili produženje pritvora.</p> <p>2. Žalbe protiv odluke Centralnog Suda će biti poslata na Apelacionom sudu, u skladu sa relevantnim zakonskim propisima.</p> <p style="text-align: center;">Član 110 Vremenski period zadržavanja u pritvornom centru</p> <p>1. Stranac može da ostane u pritvorskom</p>
--	--	--



<p>për një periudhë maksimale deri në 6 muaj.</p> <p>2. Policia Kufitare në konsultim me DSHAM-in mund të zgjatë periudhën e ndalimit në Qendër të të huajit deri në 6 muaj të tjerë, nëse brenda periudhës 6 mujore të ndalimit, largimi i të huajit ka qenë i pamundur në rastet kur:</p> <p>2.1 i huaji refuzon të japë të dhëna apo informacione personale si dhe dokumente udhëtimi të nevojshme për kthimin e tij ose paraqet informacione të rreme;</p> <p>2.2 i huaji ka penguar kthimin e tij në forma të ndryshme;</p> <p>2.3. ka vonesa në lëshimin e dokumentit të udhëtimit apo ndonjë dokumenti tjetër të nevojshëm për kthim.</p> <p>3. Shtyrja e afatit të qëndrimit në Qendrën për Mbajtje bëhet së paku 15 ditë përpara mbarimit të afatit 6 mujor të ndalimit në qendër.</p> <p>4. Gjatë kohës së ndalimit në Qendrën e</p>	<p>center for a maximum period of time of up to 6 months.</p> <p>2. Border Police in consultation with DCAM may extend detaining period at the detention center for up to additional 6 months, if within the 6 months detaining period of time, removal of the foreigner was not possible in cases when:</p> <p>2.1. foreigner refuses to provide data or personal information and travel documents necessary for his/her return, or provides false information;</p> <p>2.2. foreigner has prevented his/her return in various forms;</p> <p>2.3. there are delays in the issuance of the travel document or any other document necessary for the return.</p> <p>3. Extension of the period of detainment at the Detention Center shall be carried out at least 15 days before the expiration of the 6 months of detainment at the center.</p> <p>4. During the period of detention in the</p>	<p>centru za maksimalni period od 6 meseci.</p> <p>2. Granična policija u saradnji sa DDAM može da produži period pritvora u pritvorskome centru za dodatih 6 meseci, ako u roku od 6 meseci zadržavanja stranca u pritvornom centru, nije bilo moguće njegovo/njeno udaljavanje stranca zbog razloga, kao što su:</p> <p>2.1. stranac odbija da pruži podatke i lične informacije i potrebne putne isprave za njegov povratak, ili daju lažne informacije;</p> <p>2.2. stranac je ometao njegovo udaljavanje različitim oblicima;</p> <p>2.3. ima zakašnjenja u izdavanju putne isprave ili bilo kojeg drugog dokumenta, potrebnih za povratak.</p> <p>3. Produženje zadržavanja u Pritvorskome centru će biti najmanje 15 dana pre isteka roka od šest meseci pritvora u pritvornom centru.</p> <p>4. Tokom perioda zadržavanja u</p>
--	--	---



